



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data 20.4.2023
Nr. Prot 4034

NJOFTIM

Për zhvillimin e seancës publike nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve zhvillon seancë publike si vijon:

Data e seancës 22 Prill 2023, ora 12:00.

Rendi i ditës:

Çështje për shqyrtim rishtas:

1. Projektvendim "Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj personave përgjegjës, për raportimin e veprimtarive publike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".
2. Projektvendim "Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t'u shpërndahet si paradhënie partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023".
3. Projektvendim "Për miratimin e modelit të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe partisë politike që përfiton fondet nga buxheti i shtetit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve".
4. Projektvendim "Për shqyrtimin e kërkesave të televizioneve "Star Plus", "Syri Tv", "Klan Tv" dhe media online "Albanian Post", për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

Çështje të mbartura:

1. Projektvendim "Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".



2. Projektvendim “Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 1977/00, QV nr. 1977/01, QV nr. 1977/02, QV nr. 1977/03, QV nr. 2021/00, QV nr. 2021/01, Bashkia Tiranë, QV nr. 1080/00, Bashkia Bulqizë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

